



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJRAVE DHE**  
**SHËRBIMIT VETERINAR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Data.03.07.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - pune**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE**  
**KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: : “Rikonstruksion veshje me beton Lapardha**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**VLERA E FONDIT LIMIT** fond limit:1524951(nje milion e peseqind e njezet e kater mije e nenteqind e pesedhjet e nje leke) leke pa Tvsh..

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor \_Drejtoria e Bujqesise\_ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJRAVE DHE**  
**SHËRBIMIT VETERINAR**

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare. 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **jo më e vogël se 40 % e vlerës së Fondit Limit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës është brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, në VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJRAVE DHE**  
**SHËRBIMIT VETERINAR**

tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

**2.2.2. Operatorë ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, përvitet financiare 2021, 2022, 2023:**  
Nëse vlerësohet,

autoriteti/entiteti kontraktori mund të kërkojë që operatorë ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumit tre viteve e fundit financiare, që të regjistrojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, nën 43, pikë 4 (shënombazën ligjore), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. (Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/entiteti kontraktori)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pikë 3, e LPP, si dhe nenin 43, pikë 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertët kontabël ose shoqëritë audituese).

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJRAVE DHE**  
**SHËRBIMIT VETERINAR**

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 4/b të nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Specifikimet teknike dhe fondi limit janë përcaktuar nga Përgjegjësi sektorit ujitje**



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJRAVE DHE**  
**SHËRBIMIT VETERINAR**



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJËRAVE DHE SHËRBIMIT VETERINAR**

## **SPECIFIKIME TEKNIKE**

**OBJEKTI:**

**"VESHJE KANALI ME BETON**  
**L= 275 ml"**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJRAVE DHE**  
**SHËRBIMIT VETERINAR**

BERAT. 2024

### **Qëllimi**

Ky seksion përmban përcaktimet e përgjithshme dhe kërkesat për punimet e gërmimeve në tokë (në vëllim dhe/ose me shtresa) dhe gërmimet për struktura në kanale, përfshirë gërmim nën ujë. Më tej ajo mbulon të gjitha punimet që lidhen me konstruksionin e prerjeve, largimin e materialeve të papërshtatshme në hedhurina, dhe rifiniturat e shpatit të prerjes.

### **Përcaktimet**

#### **DHERAT**

Gërmimi në dhera duhet të aplikohet në të gjitha materialet që mund të gërmohen si me krahë, (përfshi me kazma) ashtu dhe me makineri.

#### **MATERIALE TË PËRSHTATSHME**

Materialet e përshtatshme do të përfshijnë të gjitha materialet që janë të pranueshme në përputhje me formuar mbushje ose trase.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJRAVE DHE**  
**SHËRBIMIT VETERINAR**

**Germimi**

a) Gërmimi duhet të kryhet në përputhje me nivelet dhe vijën e prerjeve sic tregohet në Vizatime. Çdo thellësi më të madhe të gërmuar në nivelin e formacionit, brenda tolerancës së lejuar, duhet të bëhet mirë me mbushje me materiale të pranueshme me karakteristika të ngjashme nga Siper marrësi me shpenzimet e tij.

b) Kujdes i veçantë duhet të ushtrohet kur gërmohen prerje për të mos hequr material përtej vijës së specifikuar të prerjes dhe më pas duke shkaktuar rrezikshmëri për qëndrueshmëri të strukturore të pjerrësisë ose duke shkaktuar erozion ose disintegrimit të pjesëve të ngjeshura.

c) Përmasat e prerjeve duhet të jenë në përputhje me detajet e seksione tërthore tip siç tregohen në Vizatime

**Trajtimi/Ngjeshja e Zonave të Gërmuara**

a) Zonat dhe pjerrësitë e prerjeve duhet të jenë konform me Vizatimet dhe duhet të rregullohen sipas një vije të pastër të standartit, për një tip të dhënë material.

b) Të gjitha zonat horizontale të gërmuara, duhet të ngjeshen me një minimum dendësie të thatë prej 95% për dhëra të shkrifet dhe 90% për dhëra të lidhur.

**Pastrimi i sheshit**

Të gjitha sheshet ku do të gërmohet, do të pastrohen nga të gjitha shkurret, bimët, ferrat, rënjet e mëdha, plehrat dhe materiale të tjera siperfaqësore. Të gjithë këto materiale do të spostohen dhe largohen në mënyrë që të jetë e pëlqyeshme nga punëdhënësi. Të gjitha pemët shkurret që janë përcaktuar nga punëdhënësi që do të ngelen do të mbrohen dhe ruhen në mënyrën e aprovuar. Të gjitha strukturat ekzistuese të identifikuar për tu prishur do të largohen sipas udhëzimeve të Mbikëqyrësit të Punimeve. Kjo do të përfshijë dhe spostimin e themeleve të ndërtimeve që mund të ndeshen.

Është shërbimeve që do të mbeten në sheshin e ndërtimit. Kosto e pastrimit të kantierit është e detyrueshme të

paguhet brenda gërmimit njësi për punimet e gërmimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJRAVE DHE**  
**SHËRBIMIT VETERINAR**

### **Gërmimi për Strukturat**

Gërmimi për strukturat duhet të jetë në përputhje me Vizatimet. Anët duhen mbështetur në menyrë të pershtatshme gjate gjithë kohës, Një alternativë është që ato mund të ngjeshen në menyrë të pershtatshme.

Gërmimet duhet të mbahen të pastra nga uji. Tabani i të gjithë gërmimeve duhet të nivelohet me kujdes. Cdo pjesë me material të butë ose mbeturina shikëmbi në taban duhet të higjet dhe kaviteti të rezultojë të mbushet me beton.

### **Gërmimi i kanaleve për tubacionet**

Kanalet do të gërmohen në dimensionet dhe nivelin e treguar në vizatime dhe /ose në përputhje me instruksionet me shkrim të Mbikëqyrësit të Punimeve. Zëri i treguar në tabelën e Volumeve (Preventiv) lidhur me gërmimet ,siç është largimi i materialit të germuar, etj. do të përfshijë cdo lloj kategorie dheu, nëse nuk do të jetë specifikuar ndryshe. Gërmimi me krahë është gjithashtu i nevojshëm në afersi të intersektiveve të infrastrukturave të tjera për të parandaluar dëmtimin e tyre. Me përjashtim të vendeve të përmendura më sipër, mund të përdoren makineritë.

Nëse nuk urdhërohet apo lejohet nga Mbikëqyrësi I punimeve nuk duhet të hapjen më shumë se 30 metra kanal përpara perfundimit të shtrirjes së tubacionit në këtë pjesë kanali. Gjerësia dhe thellësia e kanaleve të tubacioneve do të jetë sic është përcaktuar në vizatimet e kontrates, ose sic do të udhëzohet nga Mbikëqyrësi i Punimeve.

Thellimet për pjesët lidhëse do të gërmohen me dorë mbasi fundi i kanalit të jetë niveluar. Përveçse kur kërkohet ndryshe, kanalet për tubacionet do të gërmohen në nivelin e pjesës së poshtme të tubacionit si tregohet në vizatime, për të bërë të mundur realizimin e shtratit të tubacioneve me material të granular.

### **Përdorimi i Materialeve të gërmimit**

Të gjitha materialet e pershtatshme dhe të aprovuara të gërmimit duhet, persa kohë që ato janë praktike, të përdoren në ndërtim për mbushje dhe punime rrugë.

### **Ndërtimi i mbushjeve**

Tabani i dheut të shtresave është pjesë e trupit të dheut ku shpërndahen nderjet e shkaktuara nga ngarkesat e lëvizshme të automjeteve dhe e vete konstruksionit. Ky taban mund të jetë në mbushje ose në transmetojë më poshtë, në trupin e dheut ngarkesat që vijnë nga shtresat rrugore, pa pësuar deformime mbetëse.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJRAVE DHE**  
**SHËRBIMIT VETERINAR**

Mbushja gjithandej duhet te ketë nje densitet që i referuar standartit AASHTO të modifikuar, të jete max. në të thatë jo me pak se 90%, për shtresat e poshtme të ngjeshura dhe 95%, për shtresen e sipërme 30cm (subgrade).

Çdo shtresë duhet të ngjishet me lagështinë optimale duke shtuar ose tharë shtresën sipas rastit dhe kërkeses se llojit të materialit që do të përdoret në mbushje të rrugës.

Cdo shtresë e re në mbushje duhet të miratohet nga Mikëqyrësit e Punimeve, pasi të jetë siguruar se shtresa paraardhëse nuk ka deformacione ose probleme me burime uji apo lagështire të tepër.

**Perforcimi dhe veshja e gërmimeve**

Nëse gërmimi I zakonshëm nuk është I mundur apo I këshillueshëm gjatë gërmimeve duhet të vendosen struktura mbajtëse për të parandaluar dëmtimet dhe vonesat në punë si edhe për të krijuar kushte të sigurta pune. Sipërmarrësi do të furnizojë dhe vendosë të gjitha strukturat mbajtëse, mbulesë, trarë dhe mjete te ngjashme të nevojshme per sigurimin e punës, të publikut në përgjithësi dhe të pasurive që janë pranë. Sapo këto të higen të gjitha boshllëqet që mbeten nga heaja e këtyre strukturave duet të mbushen me kujdes dhe me material te zgjedhur dhe te neveshur. Siper marrësi do të jetë krejtësisht përgjegjës per sigurimin e punës në vazhdim, të punës së përfunduar, të punëtorëve, të publikut dhe të pasurive që janë pranë. Kostoja e përforcimit dhe veshies se

**Mirembajtja e gërmimeve**

Të gjitha gërmimet do të mirëmbahen sie duhet, nderkohë që ato janë te hapura dhe të ekspozuara, si gjate ditës ashtu edhe gjate natës. Pengesa të mjaftueshme, drita paralajmëruese, shenja, si edhe mjete të neveshme do të sigurohen nga Siper marrësi. Siper marrësi do të jetë pergjegjës per ndonja dëmtim personi ose pronësie për shkak të neglizhencës së tij.

**Largimi i ujërave nga punimet e gërmimit**

Si pjesë e punës në zërat e gërmimit dhe jo me kosto plus për Punedhënësin, Siper marrësi do të ndertoje te gjitha drenazhimet dhe do të realizoie kullimin me kanale kulluese, me pompim ose me kova si edhe të jashtme gjatë avancimit të punës dhe deri sa puna e përfunduar të jetë e siguruar nga dëmtimet. Siper marrësi duhet të sigurojë të gjitha pajisjet e pompimit për punimet e tharjes së ujit si edhe personelin operativ, energjin e të tjera, dhe të gjitha këto pa kosto shtesë për Punedhënësin. I gjithë uji i pompuar ose drenazhuar nga vepra duhet te higet në një mënyrë të aprovueshme prej Mbikqyrësit të Punimeve. Duhet të merren masa paraprake të nevojshme kundër përmbytjeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJRAVE DHE**  
**SHËRBIMIT VETERINAR**

**Perforcimi dhe mbulimi në vend**

Punëdhësi mund të urdhërojë me shkrim që ndonjë apo të gjitha përforcimet mbajtëse të lihen në vend me gëllim të masave paraprake për mbrojtjen nga dëmtimet të strukturave, të pronësive të tjera ose personave, nëse keto struktura mbajtëse janë shënuar në vizatime ose të vendosura sipas udhëzimeve, ose nga ndonjë arsye tjetër. Nëse lihen në vend keto struktura mbrojtëse do të priten në lartësinë sipas udhëzimeve të Mbikqyrësit të Punimeve. Strukturat mbajtëse që mbeten në vend do të shtrëngohen mirë dhe do të paguhen sipas vlerave që do të bihet dakort reciprokisht ndërmjet Sipërmarrësit dhe Punëdhënësit ose sipas mimit në Ofertë n.q.s është dhënë, ose nga një urdhër ndryshimi me shkrim.

**Mbrojtja e shërbimeve ekzistuese**

Sipërmarrësi duhet të ketë kujdes për shërbimet ekzistuese nën sipërfaqe të cilat mund të ndeshen gjatë zbatimit të punimeve dhe që kërkojnë kujdes të veçantë për mbrojtjen e tyre, si tubat e kanalizimeve, tubat kryesore të ujësjellësit, kabllot elektrike kabllot e telefonit si dhe bazamentet e strukturave që janë pranë. Sipërmarrësi do të jetë përgjegjës për dëmtimin e ndonjë prej shërbimeve si dhe duhet t' i riparojë me shpenzimet e tij, nëse këto shërbime janë ose jo të paraqitura në projekt. Nëse dëmet e shkaktuara në këto shërbime, Sipërmarrësi do të rimbursojë të gjithë koston e nevojshme për këtë riparim, dhe nëse ai nuk bën një gjë të tillë, keto kosto mund t' i bërën nga do pagesë që Punëdhënësi ka për të bërë ose do të bëjë Sipërmarrësit në vazhdim të punimeve.

**Heqja e materialeve të teperta nga gërmimi**

I gjithë materiali i tepert i gërmuar nga Sipërmarrësi do të largohet në vendet e aprovuara. Kur është e nevojshme të transportohet material mbi rrugët ose vende të shtruara Sipërmarrësi duhet ta sigurojë këtë material nga derdhja në rrugë ose ato vende të shtruara.

**Përshkrimi i cmimit njësi për gërmimet**

Cmimi njësi i zërave të punës për gërmimet do të përfshijë, por nuk do të kufizohet për gërmime në të gjithë gjerësinë dhe thellësinë, me gdo mjet që të jetë i nevojshëm, duke përfshirë gërmime me dorë, nën apo mbi nivelin e ujërave nëntoksore, ose nivelin e ujërave sipërfaqësore, përfshirë përzierje dhe të cdo lloji, përfshirë edhe gërmimet me dorë, che do të përfshijë largimin e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore në edo sasi dhe nga do thellësi, me cdo mjet të nevojshëm, do të përfshijë nivelimin, sheshimin, ngjeshjen e formacioneve, provën dhe për do punë shtesë për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJRAVE DHE**  
**SHËRBIMIT VETERINAR**

mbrojtien e formacioneve perpara cdo inspektimi, siç specifikohet, largimin dhe grumbullimin e pemëve të larguara, rilevimi topografik i kerkuar, vendosja e piketave te perhershme, dhe të atyre të përkohëshme, realizimi i matjeve, sigurimi i instrumentave për tu përdorur nga Mbikëqyresi i Punimeve, furnizimi dhe transporti i fugisë punëtore, mbajtja e vendit të punës paster dhe në kushte higjieno-sanitare, dhe cdo nevojë aksidentale e nevojshme për realizimin e Punimeve Brenda periudhes së Kontrates he pölgimit të Mbiköqyrësit t& Punimeve.

Aty ku materiali i gërmuar është përdorur për mbushje; depozitimi duke përfshirë dhe transportin në dhe nga depozitimi, ngarkimin, shikarkimin, transportin me dorë, janë përfshirë n& mimin njësi per gërmimet.

Kostoja e transportimit të materialit të tepërt të gërmuar deri në vendin e hehjes, të aprovuar nea Mbikayresi i Punimeve, nuk pörfshihet në mimin njësi të gërmimit. Kosto e transportimit të materialit te tepërt ne vendin e hedhjes mbulohet nën mimin njësi të transportit te materialeve.

Përveç transportimit të materialit të tepërt t8 gjitha lojet e transportit përfshirë ehe transportin e materialeve per përforcim, mbulim, përgatitjen e shtratit, etj përfshihen në pmimin njësi të gërmimit. Nëse nuk Eshtë pohuar ndryshe, të gjitha aktivitetet e tiera të përkruara më sipër do te konsiderohen te përfshira në mimin njësi të gërmimit.

### **Matjet**

Të gjitha zërat e gërmimeve do të maten në volum. Matia e volumit të gërmimeve do të bazohet në dimensionet e marra nga vizatimet, në të cilat përcaktohen përmesat e gërmimeve.

Çdo gërmim përtej limiteve të përcaktuara në keto vizatime, nuk do të paguhet, nëse nuk përcaktohet me parë me shkrim nga Mbikëqyrësi i Punimeve. Megjithate, nëse gërmimi është më pak se volumi I llogaritur nga vizatimet, do të paguhet volumi faktik i gërmimeve sipas matjeve faktike.

### **Punime te ndryshme.**

Ne keto punime jane parashikuar transoprti i materialeve te ndryshme me kafshe apo me auto etj, kueshte e mundur.

Gate zbatimit te punimeve te zbatohet rregullat e sigurimit teknik ne pune dhe standartet shteterore per keto lloj punimesh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJRAVE DHE**  
**SHËRBIMIT VETERINAR**

Per vete natyren e objektit dhe zones ku ndodhet ai, nderhyrja do te realizohet duke pastruar paraprakisht kanal in vadites nga mbushjet e ndryshme aluvionet, dhe veshjen e tij me shtrese betoni C25/30, t=10cm.

Para fillimit te punimeve sipermarresi te njihet me objektin , te beje rikonicionin perkates Ndryshimet e mundshme ne bashkepunimin me mbikqyresin i propozohen investitorit .

Para fillimit te punimeve te behet planorganizimi i punimeve, ne menyre qe te percaktohen vendet e hvrje daljes ne objekt , vendet e depozitimit te materialeve, levizjet e mjeteve e makinerive ngrehina te perkohshme . Do te fillohet me prerjen e bimesise ne seksionin e kanalit dhe me pas pastrimi i aluvioneve . Keto punime per vete kushtet e objektit do te realizohen me krahe nga vet punonjësit e drejtorisë sonë

Pergjegjes:

Dionisa Sinjari

*Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**NJESIA E PROKURIMIT**

Specialist I fushes

Dionisa Sinjari

Jurist

Marinela Çifliku

Specialiste (Ekon)

Makbule Muçaj

**MIRATOHET**  
**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**BLEDAR ÇILI**



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE, UJRAVE DHE**  
**SHËRBIMIT VETERINAR**